



**QENDRA.  
MULTIMEDIA.  
THEATRE.  
SHOWCASE.**

**2018**

Ky është edicioni i parë i *showcase* të Qendrës Multimedia, dhe poashtu, *showcase* i parë i organizuar ndonjëherë në Kosovë. *Qendra.Multimedia.Showcase.2018* do të mbahet në Prishtinë, nga data 19 – 21 tetor 2018 dhe sivjet në të do të shfaqen katër shfaqjet e fundit të prodhuara nga Qendra Multimedia, duke përfshi edhe premierën e shfaqjes së re *Hipokritët ose pacienti anglez*. Po poashtu, në këtë edicion, kemi përfshirë edhe shfaqjen “Le Pont”, e cila është realizuar në Paris dhe e cila do të hapë festivalin teatror që organizohet nga teatri “Adriana Abdullahu” në Ferizaj.

Pjesë e këtij *showcase* janë edhe dy panele diskutimi dhe një mbrëmje letrare e muzikore. Në këtë edicion të parë, përpos publikut Kosovar, pjesëmarrës do të jenë edhe rreth 30 mysafirë të huaj; selektorë festivalesh, kritikë, gazetarë, shkrimtarë, regjisorë e dashamirës të teatrit të cilët vijnë nga vende të ndryshme të botës.

Synimi jonë është që *showcase* të jetë i përvitshëm. Ne besojmë që nga edicioni i radhës në vitin 2019, do të zgjerohet dhe do të përfshijë edhe shfaqje të tjera të realizuara nga teatro e kompani teatrore në Kosovë. Në këtë mënyrë, ne besojmë që ky *showcase* Kosovar do të jetë një mënyrë e mirë për të promovuar në botë teatrin e izoluar Kosovar dhe një mundësi e mirë për selektorët e festivaleve, studiosit, publikun e kritikët e huaj të përcjellin, vëzhgojnë e shijojnë teatrin kosovar dhe trendet e tija teatrore. Programi i këtij edicioni të parë realizohet në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Kosovës, Teatrin Oda dhe Teatrin Dodona në Prishtinë, si dhe teatrin “Adriana Abdullahu” në Ferizaj.

## **PROGRAMI**

### **19 tetor**

20:00-21:30, Teatri Oda

Performancë teatore (premierë botërore): "HIPOKRITËT apo PACIENTI ANGLEZ"

### **20 tetor**

11:00 – 13:00, Qendra Multimedia

Panel diskutimi: Gjeografia kulturore e Ballkanit Perëndimor

15:00-17:00, Qendra Multimedia

Panel diskutimi: Shoqëritë evropiane reflektojnë për novelat kritike të krimi

20:00-21:30, Teatri Kombëtar i Kosovës

Performancë teatore: 55 SHADES OF GAY

22:00-23:00, Hammam Bar

Lexime dhe muzikë e gjallë

### **21 tetor**

11:00-12:00, Teatri Dodona

Performancë teatore: PEER GYNTI NGA KOSOVA

16:00-17:30, Teatri Kombëtar i Kosovës

Performancë teatore: NJË SHFAQJE ME KATËR AKTORË DHE DISA DERRA DHE DISA LOPË DHE DISA KUAJ DHE NJË KRYEMINISTËR DHE NJË LOPË MILKA DHE DISA INSPEKTORË VENDORË DHE NDËRKOMBËTAR

20:00-21:00, Teatri "Adriana Abdullahu", Ferizaj

Performancë teatore: LE PONT

Të gjitha shfaqjet do të ipen me titra anglisht.

## **HIPOKRITËT apo PACIENTI ANGLEZ**

Nga: Jeton Neziraj // Regjia: Blerta Neziraj & Agon Myftari // Aktrojnë: Ilire Vinca, Bajrush Mjaku, Dukagjin Podrimja, Shpëtim Selmani, Ernest Malazogu, Daniela Markaj // Skenograf: Igor Vasiliev // Kompozitor: Gabriele Marangoni // Kostumografia: Albulena Borovci // Ass. e skenografisë: Isidora Spasic // Ass. regjie: Enkeleda Simitxhiu Avdiu, Rina Galani // Dritat: Mursel Bektashi // Drejtor i teknikës: Fatlum Idrizi

Prodhuar nga Qendra Multimedia, Prishtinë // [www.qendra.org](http://www.qendra.org) / [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org)

19 tetor 2018, 20:00, Teatri Oda

Rezervimet: [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org), 049 246 555/ 038 246 555

Komedia “Hipokritët apo Pacienti anglez” merret me sistemin shëndetësor, i cili, i zënë në kurthin e kapitalizmit e të politikave neoliberalë, është shndërruar në njërin prej gangrenave kryesore të shoqërive bashkëkohore në Ballkan, dhe jo vetëm. Sistemi shëndetësor funksionon jo për t’iu shërbyer qytetarëve, por për t’i shërbyer industrisë farmaceutike, asaj të sigurimeve e spitaleve private të cilat shëndetin e pacientit e shohin si produkt prej të cilit duhet të fitohet dhe prej të cilit mund të akumulohet kapitali. Kujdesi shëndetësor është marketizuar e komercializuar, kurse institucionet shëndetësore publike funksionojnë në kushte të mjerueshme, me mjekë të korruptuar e mizantrop.

Por sistemi shëndetësor natyrisht nuk vepron i vetëm dhe i shkëputur, ai është pjesë e një hallke më të gjerë të keqpërdoruesve që vijnë jo vetëm nga biznesi farmaceutik, nga kompanitë e sigurimeve e nga kompanitë e prodhimit të aparaturave mjekësore, por edhe nga politika e nga nëntoka e krimit të organizuar.

Të pasurit marrin trajtim në klinikat e shtrenjta private në vend apo gjetiu në Evropë. Të varfërit vdesin, duke pritur në radhë në spitalet publike, ose vdesin në përpjekje për t’grumbulluar financa për t’u trajtuar në spitalet private. Kjo situatë ka thelluar pabarazinë mes shtresave sociale dhe shtetet në regjion, të udhëhequra nga elita politike të korruptuara, janë duke i kontribuar kësaj pabarazie.

Në Kosovë, rreth 50 mjekë e ish-zyrtarë qeveritar janë duke u akuzuar për skandalin e quajtur “rasti stenta”, për mashtrim, keqpërdorim të pozitës zyrtare e marrje ryshfeti. Mjekë të tjerë, ndërkohe, janë dënuar për rastin tjetër të klinikës private “Medikus”, për trafikim ilegal të organeve. Një grup tjetër ndërsa akuzohet se ka qenë duke bashkëpunuar me kompanitë farmaceutike, duke u përshkruar pacientëve barna sipas emrit të kompanisë që i prodhon.

Në komedinë “The Hypocrites or The English Patient”, 6 personazhet, na tregojnë me shumë humor, për qendrat e masazheve në Ballkan ku praktikohet ‘happy-end’-i (eufemizëm për masturbimin), për transplantin ilegal të veshkave e për operacionet

mashtuese të stentave të zemrës – krejt këto, nën hijen e punimeve intensive për ndërtimin e ‘autoudhës së paqës ballkanase’. Në “The Hypocrites...” publiku do të shohë anën ‘pornografike’ të një shoqërie e cila është duke praktikuar një *happy-end* kolektiv...

## **GJEOGRAFIA KULTURORE E BALLKANIT PERËNDIMOR: BASHKËVEPRIMI NDËRMJET ESTETIKËS DHE POLITIKËS**

Panelistë: **Sasa Ilic (SRB), Drita Lllolla (MNE), Petar Andonovski (MK), Vesa Sahatciu (RKS)**

Moderator: **Janko Ljumović (MNE)**

20 tetor, 11:00 – 13:00, Qendra Multimedia

Hyrja falas. Kontakti: [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org) / [www.qendra.org](http://www.qendra.org) / tel: 038 555 799

Ballkani Perëndimor është nocioni aktual i tërësisë gjeografiko-politike të shteteve të cilat gjenden përreth vendeve të Bashkimit Evropian. Aty hyn Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Serbia. Me futjen e këtij nocioni në diskursin politik e atë publik u hoq dorë nga termi Evropa Juglindore, i cili si i tillë përfshinte linjat e ndryshme të mbështetjes për kulturën nga fondacionet ndërkombëtare të cilat zhvillonin mbështetjen financiare dhe programore të mobilitetit dhe të bashkëveprimit të kulturave të atyre vendeve (Fondacioni për Shoqëri të Hapur, Pro Helvetia etj.). Realiteti apo konstrukti i ri del në pah pa dukshmëri të qartë linjash të mbështetjes për kulturën. Temat politike dhe ekonomike mbizotërojnë.

Paneli synon ta problematizojë vendin dhe rolin e kulturës në procesin e fushëveprimit dhe të efektit sheshazi afatgjatë në atë hapësirë. Transformimi apo tranzicioni i rrafshit të kulturës para së gjithash u takon kornizave nacionale; Kapitulli i Kulturës në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian është krejtësisht formal dhe akt protokolar i hapjes dhe i mbylljes. Cilësia e tranzicionit të kulturës si dhe përvojat e proceseve të ndryshme të cilat e përcaktuan në të tashmen nuk sollën pozicionim të qartë të sektorit të kulturës në ato shoqëri, gjegjësisht shtete.

Spektori publik ishte dukshëm i varur nga ndikimi politik, sektori i pavarur pavarësisht inovacioneve të strategjive artistike e prodhuese nuk u pozicionua si akter i barabartë i zhvillimit kulturor, derisa puna e industrive kreative varet nga madhësia e tregut dhe nga pengesat reale të cilat atë sektor nuk e bëjnë aq potent sa të ketë fuqi reale ekonomike. Fitohet përshtypja se as edhe një sektor i kulturës nuk ka hyrë në zonën e qëndrueshmërisë dhe se veprimtaria e gjithëmbarshme e sistemit kulturor funksionon pa standarde të qarta e pa vizione të zhvillimit të dëshiruar kulturor, me ndikime të fuqishme politike qoftë përmes mosveprimit apo nën petkun e qartë ideologjik të veprimit.

Paneli përbën pikën e takimit të akterëve të praktikave të pavarura kulturore të Ballkanit Perëndimor të cilët mund të ofrojnë pikëpamje për ndryshimin e mundshëm të paradigmës

e cila do të nënkuptonte para së gjithash bashkëveprimin më efikas të veprimtarisë estetike dhe politike. Si të bëhet më efikas integrimi kulturor brenda dimensionit të ri-vjetër rajonal – përmes teatrit, filmit, letërsisë apo artit vizuel? A na kanë bërë më të fortë përvojat e kaluara, apo jemi në zonën e veprimtarisë e cila është vazhdimisht e turbullt, që nganjëherë duket krejtësisht indiferente ndaj pyetjeve të cilat i parashtrajmë? Si të forcohen partneritetet e reja dhe a është produktioni i artit bashkëkohor hapësirë për krijimin e gjeografisë kulturore të Ballkanit Perëndimor, konkrete dhe përmbajtësore, e dukshme dhe dinamike, bashkëvepruese dhe e njohur?

## **SHOQËRITË EVROPIANE REFLEKTOJNË PËR NOVELAT KRITIKE TË KRIMIT**

Panelistë: **Elke Schmitter (DE), Veton Surroi (RKS), Jan Küveler (DE)**

Moderatore: **Alida Bremer (CRO/DE)**

20 tetor, 15:00 – 17:00, Qendra Multimedia

Hyrja falas. Kontakti: [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org)/ [www.qendra.org](http://www.qendra.org)/ tel: 038 555 799

Rethanat politike dhe shoqërore kanë ndikim të madh në jetën e njeriut. Mbi të gjitha, korrupsioni ka dëshmuar të jetë një nga problemet më të mëdha për funksionimin e mirë të një shteti kushtetues dhe për kushte ekonomike korrekte. Korrupsioni që si fenomen qëndron në themel të shumë probleme shoqërore, dhe që mund të qojë deri te krimi i organizuar dhe ndërlidhje fatale ndërmjet kriminelëve, politikanëve, medias dhe drejtësisë, trajtohet në mënyrë letrare, sidomos nga autorët e novelave shoqërore të krimit kritik.

Sa i përket shteteve në jug të Evropës – shtetet e Ballkanit apo shtetet e Mesdheut – besohet gjerësisht që ato kanë problem të papërmirësueshëm me korrupsion dhe përzierje në mes të politikës dhe strukturave kriminale. Por gjithashtu në Evropën Veriore, ka probleme të ngjashme, ku autorët e literaturës së krimit i referohen në mënyrë shumë të fuqishme.

Shumë autorë kanë hulumtuar dhe kanë shkruar në lidhje me këtë temë. A është dëgjuar zëri i tyre? A janë marrë ata seriozisht apo puna e tyre është hedhur poshtë si letërsi argëtuese? Çfarë mund të bëjë letërsia, çfarë mund të bëjë gazetaria? A janë a thua vendet në jug të Evropës më të prira për korrupsion se sa vendet veriore? Pse autorët francezë apo gjermanë shpesh zgjedhin si protagonistë personazhe nga ish-Jugosllavia? (psh. Estelle Subbranche, Oliver Bottini apo Leonhard F Seidl)?

## 55 SHADES OF GAY

- *Pranverë Ballkanike e revolucionit seksual* -

Nga: Jeton Neziraj // Regjia: Blerta Neziraj // Aktorë: Tristan Halilaj, Bujar Ahmeti, Shengyl Ismaili, Semira Latifi, Alketa Sylaj // Luan Durmishi (vokal) // Skenografia dhe kostumografia: Sebastian Ellrich // Muzika: Irena Popovic // Koreografia: Florian Bilbao.

Prodhuar nga Qendra Multimedia, Prishtinë // [www.qendra.org](http://www.qendra.org) / [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org)

20 tetor, 20:00, Teatri Kombëtar i Kosovës

Hyrja falas. Kontakti: [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org) / [www.qendra.org](http://www.qendra.org)/ tel: 038 555 799

Qendra Multimedia nga Prishtina, e konsideruar si 'njëra nga kompanitë teatrore më interesante nga Evropa Juglindore' [[kazaliste.hr](http://kazaliste.hr)], sjell sërish në skenë, në një trajtim krejtësisht politikisht jo-korrekt, një performancë argëtuese politike dhe provokative, kësaj here mbi çështje që kanë të bëjnë me komunitetin LGBTI.

55 shades of gay është një rrëfim burleskë për politikën rreth LGBTI në Ballkan dhe Evropë. Politikanët lokalë të Ballkanit përpiqen të manipulojnë e mashtrojnë zyrtarët e BE-së, mercenarët humanitarë të NGO-ve ndërkombëtare, e që bukur shpesh shfrytëzojnë terrenin homofob për të vjelur fonde e për të realizuar projektet e tyre sociale e edukative [të tipit të punëtorive e seminareve për mënyrën e përdorimit të kondomëve], ndërsa që zyrtarë të BE-së, duke shfrytëzuar pozitën e tyre superiore financiare e politike, përpiqen t'i nënshtrojnë të gjithë.

*Në këtë trini [Manipulim. Abuzim. Nënshtrim], pyetja që shtron shfaqja është: a është i mundur një çlirim seksual [sexual liberation] në Ballkan? Ose, a mundet Ballkani ta nisë një 'Pranverë ballkanike të revolucionit seksual'?*

Në shfaqje, një çift gay bën kërkesë për kurorëzim në një qytet provincial konservativ dhe thellësisht homofob. Kërkesa bëhet në kohën kur shoqata italiane Don Bosco ka nisur në qytet ndërtimin e një fabrike për prodhimin e prezervativëve, një projekt ky që është përkrahur financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe që synon zvogëlimin e papunësisë në atë qytet ku papunësia shkon deri në 90%. Intelektualë, artistë, politikanë, përfaqësues të fesë e bombahedhës profesionistë angazhohen që kjo martesë të mos ndodhë, pavarësisht se martesë e çifteve të së njëjtës gjini lejohet me kushtetutën e vendit, të cilën kryeministri e ka nënshkruar simbas udhëzimeve të BE-së.

*55 shades of gay është realizuar nga një kastë e 5 aktorëve të mrekullueshëm kosovarë dhe nga një ekip i artistëve teatrore eminentë nga Gjermania, Kosova, Franca dhe Serbia.*

## **PEER GYNTI NGA KOSOVA**

Nga: Jeton Neziraj // Regjia: Agon Myftari

Aktorë: Tristan Halilaj, Donikë Ahmeti, Shpëtim Selmani, Ernest Malazogu

Skena: Nicola Minssen // Kompozitor: Gabriele Marangoni // Kostumet: Yllka Brada // Dramaturg: Stefan Schletter

Prodhuar nga Qendra Multimedia, Prishtinë / [www.qendra.org](http://www.qendra.org) / [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org)

21 tetor, 11:00 – 12:00, Teatri Dodona

Rezervimet: [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org) / [www.qendra.org](http://www.qendra.org) / tel: 038 555 799

Peer Gynti nga Kosova është rrëfim për një ëndërr të dështuar. I udhëhequr nga një shpresë e thjeshtë për jetë më të mirë dhe për të gjetur lumturinë, Peeri i ri, para luftës në Kosovë, nisët për të kërkuar të ardhmen në ‘parajsën’ e quajtur Evropë.

Ajo çka ndodhë me këtë të ri gjatë këtij udhëtimi reflekton eskperiencat e shumë desperadove të rinjë të cilët çdo vjet, të mbushur me shpresë, lëshojnë atdheun e tyre. Shpesh, në atdheun e tyre të ri, të keqtrajtuar nga autoritetet, të izoluar dhe larg nga shtëpia, me mungesë perspektive dhe të mospërfshirë në shoqëri, atyre ëndërra u bëhet një makth i madh.

Në dëshirën e tyre për t’u pranuar ata shpesh biejn viktima të shokëve të këqinjë, të cilët ua ofrojnë “sigurinë e munguar”. Peer, personazhi kryesor i kësaj drame, e gjenë vehten të respektuar në një grup shqiptarësh të cilët ia tregojnë atij shkathtësitë kriminale dhe i garantojnë siguri. Megjithatë, pavarësisht kësaj, ai shpejt bie në burg. Gjatë kësaj periudhe në burg, gradualisht fillon procesi i radikalizimit. Religjioni i jep atij kurajo, kuptim në jetë dhe ia forcon vetëbesimin. Këtu drama merret me një problem aktual në shoqëritë tona – radikalizimin religjioz të të rinjëve në burgje. Shumë nga këta të ashtuquajtur ‘luftëtarë të shenjhtë’ nga Evropa, të cilët luftojnë në Siri, janë radikalizuar në burgje.

Por pavarësisht seriozitetit të temës, shfaqja asnjëherë nuk bëhet patetike apo didaktike. Në fund, publiku e lë shfaqjen jo vetëm i merakosur dhe kuptimplotë, por edhe I argëtuar në mënyrë perkfekte.

## **NJË SHFAQJE ME KATËR AKTORË DHE DISA DERRA DHE DISA LOPË DHE DISA KUAJ DHE NJË KRYEMINISTËR DHE NJË LOPË MILKA DHE DISA INSPEKTORË VENDORË DHE NDËRKOMBËTAR**

Nga: Jeton Neziraj // Regjia: Blerta Neziraj // Aktorë: Shengyl Ismaili, Adrian Morina, Ernest Malazogu, Shpëtim Selmani // Muzikantë: Art Lokaj (electric guitar), Drin Tashi (drums) // Muzika: Gabriele Marangoni // Koreografia: Adrienne Hart // Skenografia: Petra Veber // Kostumografia: Vesa Kraja // Ndriçimi: Radomir Stamenkovic

Prodhuar nga Qendra Multimedia, Prishtinë / [www.qendra.org](http://www.qendra.org) / [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org)

21 tetor, 16:00, Teatri Kombëtar i Kosovës

Rezervimet: [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org) / [www.qendra.org](http://www.qendra.org) / tel: 038 555 799

Mbas daljes tragjikomike të Britanisë së Madhe nga BE, vendi i ngelur bosh duhet të plotësohet shpejt, përndryshe BE do të mund shkatërrohet. Evropa ka kthyer sytë nga Kosova, e cila papritur gjendet para një mundësie historike të cilën ajo medoemos dëshiron ta shfrytëzojë. Por, siç ngjan zakonisht, ekziston edhe një sfidë e madhe. Pos Kosovës, mundësinë për të hyrë në BE e ka edhe Serbia. Njerëz dhe kafshë në Kosovë mobilizohen t'i plotësojnë më mirë dhe më shpejtë se sa Serbia standardet që Evropa ka vënë si kusht. Dokumenti bazë i EU-së, që u dorëzohet autoriteteve kosovare, quhet *Kosova dhe 3,000 rregullat e lehta të rrugës evropiane*.

Thertorja Tony Blair në Prishtinë, nga tash e tutje, duhet të fillojë të shesë mish me cilësi dhe prejardhje të kontrolluar. Në përpjekjen e tyre për të plotësuar këtë kusht, pronarët e thertoresh bëjnë një udhëtim kafkian nëpër administratën qeveritare, duke pasur të bëjnë me burokratë e zyrtarë halabakë e të korrumpuar. Madje, në kopshtin zoologjik të Shkupit, atyre u duhet të vjedhin edhe një gjirafë për Kryeministrin e Kosovës, të cilin ai e ha për ditëlindjen e tij.

Dhe derisa njerëzit e shtetit të ri angazhohen me naivitete në këtë *sfidë të re*, bota *orvelliane* e kafshëve mobilizohet dhe dëshiron ta shfrytëzojë këtë *momentum politik* për të adresuar e artikuluar kërkesat e tyre për *therje më të dinjitetshme*.

E shkruar nga një cinik vendas, kjo shfaqje teatri është një panoramë tragjikomike e realitetit të tanishëm kosovar dhe atij evropian. Aspirata e sinqertë e kosovarëve për në BE konfrontohet, në njërën anë, me rregullat e kërkesat e koklavitura dhe qesharake evropiane dhe, në anën tjetër, me hilen e burokratëve për t'i bërë gjërat *'të duken ok vetëm në letër'*.

## **LE PONT**

Bazuar në novelën "Ura me tri harqe" nga Ismail Kadare // Adaptim dhe regjia nga: Simon Pitacaj // Aktorë: Rexhep Mitrovica, Arben Bajraktaraj dhe Cinizia Menga // Përktimi: Jusuf Vrioni // Asistente e regjisë: Santana Susnja // Bashkëpunëtor i dramaturgisë: Jean-Baptiste Evette // Ndriçimi: Flore Marvaud // Kompozitor: Liburn Jupolli // Kosumet: Vjollca Mjaku // Dekorimi: Emanuel Macaigne

Prodhuar nga Compagnie Liria Teatër, Paris / [liriateater@gmail.com](mailto:liriateater@gmail.com) / [www.comapgnieliria.com](http://www.comapgnieliria.com)



Performanca do të jetë në frëngjisht me titra shqip

21 tetor, 20:00, Teatri “Adriana Abdullahu” Ferizaj

Një prift është dëshmitar i ndërtimit të një ure të gurit mbi lumin e paqëndrueshëm Ouzane, në vendin e tragetit antik. Projekti i udhëhequr nga të huaj misteriozë, sabotohet vazhdimisht. A ishin këto manifestim i Shpirtërave të Ujit, si për ato që nëna e vjetër Ajkuna fliste? Apo shkatërroheshin ato nga ndonjë punëtor i kompanisë së ndërtimit – Lundra dhe trape? Thashetheme të ndryshme dhe mospërputhëse po fillojnë të përhapen, dhe edhe eme shumë sepse duket që fqinji i fuqishëm Osman është duke u afruar edhe më afër, shumë pranë për të gëlltitur gjithçka.

Në moment të tillë të trazirave dhe paqartësisë, paraqitet një karakter misterioz: korrësi. I arritur së bashku me punëtorët e ndërtimit, ai po pyet priftin në lidhje me legjendat e vjetra lokale. Me dashamirësi të pafajshme, prifti i tregon atij histori, por edhe shumë sekrete. Baladat e vjetra nganjëherë i ndriçojnë rrënjët e vjetra të vendit, përkushtimin për fjalën e dhënë dhe situatën e momentale të paqartë. A do të jetë ura një nga ato portat ndërlidhëse ndërmjet botës së të vdekurve dhe asaj të të gjallëve, ashtu siç përmendet në të thënat antike? A do të ofrohet një sakrificë njerëzore për themelet e urës, si në atë historinë ndërtuar nga tre vëllezër?

Përderisa prifti dhe korrësi po diskutojnë për interpretimin e gojëdhënave, një numër i karaktereve fascinuese shfaqen: vëllau i ri i detyruar të sakrifikojë gruan e tij për “nusen e turkut”, apo edhe Murrash Zenebishe – njeriu i rëndomtë, të afërmit e tij, gruaja dhe djali. Larg nga substanca fillestare, legjendat antike në duart e korrësit do të shërbejnë si armë të tmerrshme që synojnë ofrimin e sakrificës së gjakut dhe i hapin rrugë pushtimit ogurzi turk.

“Unë nuk sugjeroj një temë, përkundrazi tema më zë mua”. I rritur në një fshat të Kosovës, Simon Pitaqaj, vërteton fjalët e Jorge Luis Borge. Tregimi shumë poetik i ngritur i Ismail Kadaresë e sjellë atë në ditët e vjetra, hijet e varrosura të së shkuarës dhe fuqinë arkaike të tregimeve, me fjalë të tjera, në nevojën e kaplimit të historisë në teatër. Është viti 1377 dhe aventura të çuditshme përhapen gjithkund në ndërtimin e një ure mbi lumin Ouyane. Metaforikisht ato ndjellin tranzicionin lëkundës ndërmjet antikes feudale dhe urdhërave të ri të tregtisë, po ashtu edhe lidhjen në mes të botës të të vdekurve dhe asaj të të gjallëve. Viktimat sakrifikuere të murosur, shkatërrimi gjatë natës e asaj që është ndërtuar ditën, këtu legjendat janë duke shtyer një histori të madhe, përderisa më saktësisht një pushtim i Perandorisë Osmane është duke u kanosur. Prifti Gjon është duke dëshmuar, duke e përfshirë një karakter misterioz: korrësin.

Dy aktorë të shquar performojnë. Rexhep Mitrovica është prifti dhe Arben Bajraktaraj është korrësi. (Agnès Santi në *La Terrasse*)

Frëngjisht me titra në gjuhën shqipe.